

VENDIM
Nr.527, datë 11.12.1992

**PËR NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.326, DATË
28.8.1991 "PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE"**

Për të mbrojtur rrjetin elektrik nga dëmtimet, të shkaktuara nga rritja e ngarkesës si pasojë përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje, me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 28.8.1991, të shtohet:
Nga data 1.1.1993 gjer më datën 31.3.1993 çmimi i shitjes me pakicë të energjisë elektrike që përdoret për ngrohje nga 250 deri në 300 kwh në muaj për përdorues në zonën e parë, nga 150 deri në 200 kwh në zonën e dytë dhe nga 70 deri 120 kwh në zonën e tretë, të bëhet 1 lekë për kilovat-orë, kurse çmimi për sasinë mbi këta kufij të çdo zone të bëhet 3 lekë për kilovat-orë.

2. Pas pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326, datë 28.8.1991, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"Të ardhurat që do të realizohen për efekt të ndryshimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike mbi normativë, të përdoren nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare për rikonstruksionin e rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi